



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:272915

Datë: 06.08.2024

Numri i dokumentit: 06022595

**C.nr.2718/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil,** gjyqtari Berat Spahiu, me bashkëpunëtoren profesionale Emine Hoti, në çështjen juridike të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. /KEDS/ me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, kundër të paditurit E.N.I nga fsh....., Komuna e Gjilanit, për kompenzimin e dëmit material, vlera e kontestit 71.59 Euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 06.08.2024, merr këtë:

**AKTGJYKIM  
PËR SHKAK TË MOSBINDJES**

**I.**Aprovohet kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. /KEDS/ me seli në Prishtinë, kundër të paditurit E.N.Inga fsh....., Komuna e Gjilanit dhe detyrohet i padituri që paditëses, t’ia paguaj shumën prej 71.59€, në emër të dëmit material për shkak të shfrytëzimit të kundërligjshëm të energjisë elektrike, me kamatë ligjore prej 8%, në vit, e llogaritur nga data 07.12.2023, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

**II.**Detyrohet i padituri, që paditëses t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20 Euro, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm ligjor.

**A r s y e t i m**

Paditësja, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A./KEDS/ me seli në Prishtinë, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit R.I nga fsh....., Komuna e Gjilanit dhe ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditëses, t’ia paguaj shumën prej 71.59€, për shkak të dëmit material të shkaktuar për shfrytëzim të kundërligjshëm të energjisë elektrike, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke llogaritur nga data 07.12.2023, e deri në pagesën përfundimtare.

Paditësja pretendimet në padi i ka mbështetur në faktin, se në bazë të Aktgjykimeve të formës së prerë P.nr.149/2022 të datës 04.04.2022, i cili është bërë i plotfuqishëm më datë 03.05.2022, i padituri është shpallur fajtor për shkak të veprës penale “vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, përderisa e dëmtuara tani paditësja është udhëzuar në kontest civil për kompenzimin e dëmit të shkaktuar në lidhje me veprën penale të lartëpërmendur. Tutje paditësja ka shtuar se i padituri me qellim që ti sjell vetes pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ka bërë lidhjen e drejtëpërdrejtë në

rrjetin e tensionit të ulët duke e anashkaluar nëhsorin elektrik, me çka është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike, në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS- Distrikti në Gjiilan, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 71.59€, dhe për realizimin e kërkesës pasurore juridike, paditësja është udhëzuar në kontest civil.

Për të mbështetur pretendimet si në padi, si prova materiale ka propozuar që të administrohen: Aktgjykimi P.nr.149/2022 i datës 04.04.2022, dhe Fatura DGLHP221511 e datës 10.01.2022.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata ka nxjerr Aktvendimin për përgjegje në padi, C.nr.2718/23, të datës 15.05.2024, të cilin sipas fletëkthesës për dorëzim personal, i padituri e ka pranuar më datë 21.06.2024, aktvendimin për përgjegje në padi, i padituri ka qenë i njoftuar për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore në rast të mosparaqitjes së përgjegjes në padi, respektivisht për mundësinë që në rast të plotësimit të kushteve ligjore, gjykata do të nxjerr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë. Pavarësisht pranimit të aktvendimit për përgjegje në padi së bashku me të gjitha shkresat e lëndës, i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Neni 150 par.1 të LPK-së, përcakton: *“Në qoftëse i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.*

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), edhe atë nenit 8 i cili përcakton “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit”; nenit 136, paragrafi 1 se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”; nenit 137 se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”; nenit 140 se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, të përcaktuara në nenin 150.1 i LPK-së, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e këtij aktgjykimi janë plotësuar, pasi që të paditurit i është dorëzuar me rregull aktvendimi për përgjegje në padi, ndërsa themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, e sidomos nga aktgjykimi penal i lartëcekur ku është përcaktuar edhe lartësia e dëmit material të shkaktuar me vepër penale, e po ashtu, se faktet në padi nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga vet paditësja apo me faktet e ditura botërisht. Kamatëvonesa është gjykuar në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me këtë çështje civile, gjykata ka vepruar konform nenit 485.1 të LPK-së, për procedurat në kontestet e vlerës së vogël, ngase sipas kërkesave të paditëses, vlera e kontestit nuk e kalon lartësinë mbi 500.00€, andaj i padituri lidhur me të drejtën e ankesës dhe afatin e saj duke përfshirë edhe shkaqet e ankesës është udhëzuar nga ana e gjykatës konform nenit të

lartëcekur, ku në mënyrë shprehimore është përcaktuar se “Konteste të vlerës së vogël, në vështrim të dispozitave të këtij kreu, janë kontestet në të cilat kërkesëpapia ka të bëjë me kërkesa në të holla, shuma e të cilave nuk është më e madhe se 500.00€.

Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës konform nënit 452.1 të LPK-së, duke e detyruar të paditurin, që paditëses t’ia kompenzoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20.00€, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ligjor.

Nga të lartëcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:272915, 06.08.2024**

Gjyqtari ,  
Berat Spahiu

**Udhëzim me mjetin juridik:** Kundër këtij Aktgjykimi, konform nenit 491.3 të LPK-së, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit aktgjykimit, përmes kësaj gjykate  
Konform nenit 491.1 të LPK-së, Aktgjykimi mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.